



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS
PROCESVERBAL

KONSULTIMIT PUBLIK

**PROJEKTVENDIM “ PËR MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE PËR
NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË PËRDORIMIT TË FONDIT PYJOR PUBLIK TË
SIPËRFAQES 0,677 HA, SHFRYTËZIM MINERAL KROMI ME KARRIERË NË FUNKSION
TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË “PEPA GROUP” SH.P.K, LEJE MINERARE NR.1886/1”.**

Me datë 27.06.2024, ora 12:00, në fshatin Fusharë, njësia administrative Surroj, u zhvillua seanca e konsultimit publik, sipas njoftimit përkatës.

Takimi hapet nga kryetari i këshillit, z. A.M, i cili shpjegon projektvendimin dhe kërkon nga qytetarët mendime, sugjerime mbi këtë kërkesë.

G.V, administrator i njësisë: Në kohën kur është marrë leja mjedisore nga subjekti PEPA GROUP, unë kam qenë kryetar fshati. Kemi qenë 30 veta që kemi rënë dakord. Është bërë një marrëveshje me subjektin për punësim dhe investime. Ne si komunitet kemi shumë nevoja. Pse këshilli bashkiak nuk merr masa për plotësimin e kërkesave tona?

S.V: Unë jam punonjës i kësaj firme që prej kur ka filluar punë. Nuk kemi pasur asnjëherë asnjë konflikt mes banorëve dhe firmës. Parimi i kësaj firme është puna në marrëveshje me banorët. Na kanë ndihmuar me makineri për pastrimin e rrugëve, pastrim bore. Është firmë korrekte.

V.V: Është një nddër firmat më korrekte. Nuk kemi asnjë vërejtje.

Sh.S: Aty ku punon firma. Nuk kemi pas asnjëherë probleme.

A.V: Është firmë që na ka qëndruar afër për çdo problem. Neve nuk na janë plotësuar kërkesat nga bashkia, na i ka plotësuar kjo firmë.

I.N: Firma është shumë korrekte.

V.N: Aty ku bëhet puna, ne si fis kemi pronësinë. Shumë banorë që kanë pronat aty nuk janë të pranishëm sot.

Qytetar tjetër: Firma ka bërë marrëveshje me banorët që të mos hyjë brenda kufinjve.

G.V: Në territorin e Surroj janë 14 leje minerare. Janë pak prej tyre që kanë dokumentacion të rregullt. Si do zgjidhet kjo problematikë?

Nuk ka diskutime të tjera. Mbyllet takimi.